

Mediat e huaja pasqyrojnë gjerësisht vendimin e Autoritetit të Konkurrencës për AMC dhe Vodafone

Vendimi i Autoritetit të Konkurrencës mbi abuzimin me pozitën dominuese të “Albanian Mobile Communication sh.a.” dhe “Vodafone Albania sh.a.” në Tregun e Telefonisë së Lëvizshme, është pasqyruar gjerësisht nga mediat ndërkombëtare.

Për këtë vendim, kanë shkruar media prestigjioze ndërkombëtare se International Herald Tribune, Associated Press, Yahoo News, Zëri i Amerikës, People’s Daily Kinë, etj.

Vendimi i Autoritetit të Konkurrencës, është pasqyruar edhe nga media të specializuara në fushën e komunikimeve elektronike, (TMCnet, Wireless-watch), konsumatorëve (mobileguerrilla) etj.

Ju lutem më poshtë gjeni artikullin e publikuar në Herald Tribune si dhe intervistën e Znj. Lindita Milo (Lati) Kryetare e Autoritetit të Konkurrencës të dhënë për Zërin e Amerikës edicioni shqip.

Herald Tribune

Dy operatorët e telefonisë së lëvizshme shqiptare u gjobiten me 3.76 milion euro (5.52 milion \$) për çmime jo të drejta.

Autoritetet thanë të hënën se dy operatorët e telefonisë së lëvizshme shqiptare, “Albanian Mobile Communication” dhe “Vodafone Albania”, janë gjobitur me një vlerë prej 5.52 milion \$, për abuzim ndaj konsumatorit.

Autoriteti i Konkurrencës i vendit në fjalë gjobiti me vlerën 211.5 milion lek kompaninë “Albanian Mobile Communication”, ose thënë ndryshe, AMC-në dhe “Vodafone Albania” me vlerën prej 242.6 milion lek (2 milion euro, 2.94 milion \$), për cenimin e ligjit të antitrustit dhe abuzimin me pozicionin e tyre dominues. Thuhet se këto kompani kanë vënë çmime jo të drejta në treg.

Këto kompani kanë vendosur tarifa shumë më të larta se tregu European dhe mesatarja e rajonit në vitin 2004-2005.

Të dyja palët, si AMC-ja dhe Vodafone thanë se kishin nevojë ta rishikonin dhe një herë vendimin e komisionit përpara se të jepnin një përgjigje rreth kësaj.

AMC-ja e ka nisur aktivitetin e saj në vitin 1996 si një kompani shtetërore dhe më pas, në vitin 2000, 85 % të aksioneve iu shitën kompanisë Greko-Norvegjeze, “KozmoteTelenor”, ndërsa “Vodafone Albania” e ka nisur aktivitetin e saj në Gusht të vitit 2001. Tashmë, së bashku ata kanë më shumë se 2 milion abonentë.

Shqipëri: AMC dhe VODAFON gjobiten për shkelje ligjore në tregun e telefonisë

Ilirian Agolli, Tiranë

Zëri i Amerikës

26-11-2007

<http://www.voanews.com/albanian/2007-11-26-voa6.cfm>

Në Tiranë, Autoriteti i Konkurrencës gjobiti sot me 5,5 milionë dollarë dy kompanitë e telefonisë celulare AMC dhe VODAFONE, për shkelje të rregullave të tregut. Lindita Milo, kryetare e këtij institucioni thotë në një intervistë për Zërin e Amerikës se këto dy kompani të shërbimit celular, si edhe ALBTELEKOM-i, kompania e sapoprivatizuar e telefonisë fikse, janë vendosur nën vëzhgim të pandërprerë për mënyrën se si po sillen në tregun e veçanti të tele-komunikacioneve. Zonjën Milo e intervistoi kolegu ynë në Tiranë, Ilirian Agolli.

Zëri i Amerikës: Zonja Milo! Si drejtuese e Autoritetit të Konkurrencës, a mund të na thoni, ju lutem, gjordat që i keni vendosur kompanive të telefonisë celulare AMC dhe Vodafone, si edhe arsytet pse janë vendosur ato?

Lindita Milo: Autoriteti i Konkurrencës e ka patur nën hetim të përgjithshëm sjelljen e dy kompanive të telefonisë së lëvizshme, duke vërtetuar se ato dy kompani kanë abuzuar në pozitën e tyre dominuese. Duke qenë në kundërshtim dhe në shkelje të ligjit për konkurrencën ato janë gjorbitur. Dua të veçoj se edhe më parë AMC është gjorbitur për efekt të procedurave, pasi nuk i ka sjellë Autoritetit të Konkurrencës informacionin e kërkuar. Ky dënim është tjetër dhe doja ta ndaja dukshëm nga gjoba tjetër që AMC dhe Vodafone ka marrë për praktikant antikonkurruese që është vërtetuar në sjelljen e tyre. Gjoba e tyre është një nga më të rëndat, sipas ligjit 2-10 për qind të xhiros vjetore për periudhën kur ato janë studiuar. Kemi vendosur shumën 5,5 milionë dollarë të dy kompanitë së bashku.

Zëri i Amerikës: A kanë dndodhur më parë shkelje të ligjit nga kompani të telefonisë celulare dhe nga Albtelekomi?

Lindita Milo: Ne nuk flasim për tarifatat sepse ato i vendos tregu dhe entet rregullatore sias ligjeve në fuqi. Institucioni ynë vzhgon sjelljen e kompanive në treg. Gjithashtu me shumë kujdes ne kemi trajtuar edhe Albtelekom-in dhe privatizimin e tij, si edhe faktin e kalimit të tij nga një monopol shtetëror në një pronar tjetër. Në mënyrë specifike jemi shprehur që ky treg është totalisht nën monitorimin e Autoritetit të Konkurrencës. Si telefonja e lëvizshme ashtu edhe ajo fikse, për vetë faktin se kjo e fundit është ende një lojtar i vetëm në treg për disa nga produktet.

Zëri i Amerikës: Zonja Milo. Vëzhgues të ndryshëm të ekonomisë shqiptare janë shprehur me shqetësim për monoploet dhe oligoploet në ekonominë shqiptare. Cilat janë përpjekjet tuaja për të funksionuar më mirë ekonomia e tregut në Shqipëri me rregullat e konkurrencës?

Lindita Milo: Autoriteti i Konkurrencës kërkon pak më shumë kohë sepse ka filluar si institucion në vitin 2004 dhe ka mungesë të dhënash për të bërë një paraqitje dhe diagramë totale të gjithë strukturës së ekonomisë së vendit. Jo strukturat e tregut, por praktikant antikonkurruese dhe sjellja e firmave në treg janë ato që shqetësojnë Autoritetin e Konkurrencës. Pra, nuk është pozicioni monopol që na shqetëson, por abuzimi me këtë

pozicion, shkelja e ligjit duke përfituar nga pozicioni i vecantë në treg i disa kompanive.
Autoriteti i Konkurrencës do të ndikojë në qeveri që të liberalizohen licensat, në mënyrë që të liberalizohet tregu. (ze)